

Syllabusi i lëndës Hadithi II-

Lënda: Hadith II - *Studime në librat e hadithit*

Programi i studimit: Studime Islame

Numri i ECTS kredive: 6

Statusi i lëndës: Obligativ

Kodi i lëndës: 204

Fondi i orëve: 2 + 2

Viti akademik: 2024/2025

Semestri: III-të

Mësimdhënësi: Prof. asoc. Dr. Sulejman Osmani

Përmbajtja e shkurtër e lëndës:

Shtjellimi i parimeve bazë të besimit.

Besimi nënkupton fjalë dhe vepra, trajtimi i argumenteve dhe analiza.

Kultivimi i virtyeteve që burojnë nga besimi, nga prizmi i jetës dhe vdekjes.

Fraksionet fetare dhe qëndrimi i tyre ndaj veprave, si produkt i njeriut.

Parimet e besimit urdhërojnë për vepra të mira dhe ndalojnë nga e keqja.

Qëllimi i lëndës

- Lënda ka për qëllim studimin e tematikave të ndryshme që përfshihen në librin mbi Besimin, (Kitabul Iman) duke filluar nga ato që paraqesin kushtet bazë të Islamit. Besimi i drejtë identifikon edhe qëllimin e krijimit, arsye për të cilën Allahu ka krijuar gjithësinë.

- Studenti duhet të kultivon vlerat e besimit duke praktikuar detyrat që i obligon Islami e të cilat sjellin favore dhe realizojnë interesa që lidhen me jetën praktike. Është shumë esenciale që të mësohet të ndërtoj relacion të drejtë me normat e besimit . Për këtë e ndihmojnë, tematikat e shtjelluara në "Librin mbi Besimit" dhe synojnë këtë arritje.

- Gjithashtu qëllimi i lëndës është ndërtimi i karakterit të fortë të studentit i cili nëpërmes detyrave të besimit i shërben interesit shoqërorë.

- Lënda synon të identifikoj detyrat bazë të fesë duke u nisur nga ato më elementare që kapin shumë objektiva. Islami është ngritur mbi pesë shtylla dhe lënda synon që të ofroj njohuri të bollshme dhe të argumentuara rreth njohjes së tyre. Ky kapitull mbulohet shumë ngjeshur me argumente nga fusha e hadithit, si burim i dytë i legjislacionit Islam.

- Po ashtu lënda synon të ofroj argumente mbi domosdonë e vazhdimësisë në rrugën e drejtë duke u larguar nga devijimet e mundshme të cilat vazhdimisht mund të paraqiten në rrugë.
- Lënda ka për objektiv studimin e metodave edukative të përdorura nga Muhamedi a.s. duke pasur parasysh shtresat e ndryshme në shoqëri dhe dallimet në mes tyre.
- Aftësimi i studentit për lexim të drejtë të tekstit të hadithit dhe komunikimi me te paraqesin një nevojë shumë objektive.
- Studenti përveç kuptimit të temave të ndryshme do të mësojë edhe shumë fjalë arabe me çka dukshëm do të zgjeroj horizontin e diturisë.

Rezultatet e pritura të nxënies:

1. Studenti do të njoftohet me punën e hadithologëve në transmetimin e hadithit, gjegjësisht do të njohë metodën e tyre, sakrificën dhe përkushtimin.
2. Do të aftësohet të lexoj tekstet e haditheve, ti kuptoj e përkthej ato.
3. Do të njoftohet me mënyrën e sjelljes së Pejgamberit a.s. ndaj atyre që janë averziv dhe tolerancën që ai kultivonte në raste të tilla.
4. Përvetësimi i metodave të ligjërimit dhe komunikimit me të tjerët.
5. Do të kuptoj trajtimin parimor të të gjitha detyrave fetare, Islame dhe peshën e rëndësishme që paraqesin ato në jetën e besimtarit.
6. Do të njoftohet me mendime të ndryshme të dijetarëve të cilët shumë herë mundë të mos jenë të një mendimi.
7. Do të kuptoj edhe shumë argumente fetare që konfirmojnë fenomene të ndryshme të cilat do të simbolizojnë periudhën e fundit të jetës në këtë botë.

Metodologjia e mësimdhënies:

1. Mësimi zhvillohet ne formë të ligjëratave, që kryesisht janë të natyrës teorike,
2. Stimulimi i studentëve ne diskutime interaktive, duke ballafaquar idetë dhe argumentet.
3. Përdorimi i mjeteve konkretizuese për të ofruar sqarime të duhura në lidhje me identifikimin e lëndës dhe specifikave të saj.
4. Leximi i teksteve në gjuhën arabe dhe përpunimi i materies shkencore në aspektin praktik.

Përmbajtja e lëndës:

Java e parë:

1. Njohja me studentët dhe lëndën mësimore.
2. Paraqitja e sylabusit dhe prezantimi i metodës së mësimdhënies.
3. Praktikat e mësimdhënies në sistemin arsimor te

myslimanët, teoria dhe praktika. 4. Metoda e dijetarëve të hadithit në mësimdhënie dhe mësimnxënie, raportet në mes nxënësit dhe mësuesit.

5. Njohuri mbi autorin e librit: "Sahihu i Muslimit" të autorit: Muslim bin El Haxhaxh El Kushejri, 6. Jeta dhe vepra, 7. Arritjet e tij në fushën e shkencave Islame e veçanërisht në atë të hadithit. . Disa njohuri të nevojshme rreth komentuesit të "Sahihu i Muslimit" imam Neveviut dhe kontributi i tij në këtë fushë. . Arsyet e avancimit të komentit të tij ndaj gjithë të tjerëve dhe vlerësimet e kritikëve. 10. Studime krahasimore.

Java e dytë:

1. Njoftimi me librin " Sahihu i Muslimit" i autorit Muslim bin El Haxhaxh. 2. Rëndësia e tij në shkencën e hadithit, rangimi dhe vlera. 3. Metodologjia e punës së tij me theks të veçantë ana teknike dhe artistike. 4. Cilat janë veçorit kryesore të punës së tij

5. Prezantimi i hadithit bazë. 6. Përqendrimi në leximin e tekstit nga ana e mësimdhënësit e më pas nga studentët, ku përfshihen të gjithë.

Literatura: Libri "Sahihu Muslim" vëllimi i parë faqe 101 (Teksti i hadithit)

Java e tretë:

1. Përpunimi i tekstit të hadithit. 2. Sqarimi i termave dhe fjalëve të panjohura. 3. Analiza e vargut të transmetuesve. 4. Praktika e kalimit nga një sened në tjetrin dhe arsyet e një veprimi të tillë.

5. Komenti i përgjithshëm i hadithit të parë dhe shtjellimi tematik. 6. Domethënia e Imanit, Islamit dhe Ihsanit, sipas konceptit të fesë Islame. 7. Paraqitja e parashenjave të kiametit. 8. Largimi i Xhibrilit

Literatura: Libri "Sahihu Muslim" vëllimi i parë faqe 101 -111

Java e katërt:

1. Besimi në dijen dhe caktimin(kada dhe kader) e Allahut 2. Analiza e metodologjisë së komunikimit të Xhibrilit me Muhamedin a.s. 3. Çështja e momentit të ndodhjes së kiametit dhe parashenjat e tij. 4. Ardhja e Xhibrilit që t'ua mësoj fenë të tjerëve.

5. Leximi i hadithit nr. 5. faqe 115. 6. Përpunimi i tekstit, fjalët dhe fjalitë e panjohura. 7. Sqarimi i pesë fshehtësive të cilat nuk i di askush tjetër përveq Allahut. 8. Komenti i ajetit 34 nga sureja Lukman.

Literatura: Libri "Sahihu Muslim" vëllimi i parë faqe 115-119

Java e pestë: Kollokfijum- seminare

Testim i njohurive të fituara, dhe vlerësimi me pikë

Java e gjashtë:

1. Leximi i hadithit nr. 8 faqe 119. 2. Sqarimi i namazit si njëra nga pesë shtyllat e Islamit. 3. Paraqitja e bedunit dhe komunikimi me Pejgamberin a.s. 4. Sqarimi i pesë shtyllave të Islamit.

5. Leximi i hadithit nr. 10 faqe 122 6. Sqarimi dhe komentimi i termave dhe fjalëve të panjohura 7. Bisedë rreth tematikës së hadithit dhe analizë e tekstit. 8. Ndalimi i shtrimit të pyetjeve për çështje të parëndësishme. 9. Edukata dhe mirësjellja e shokëve të Muhamedit a.s. 10. Nevoja e verifikimit të burimit të informatës, besimi duke medituuar në krijesat e Allahut.

Literatura: Libri "Sahihu Muslim" vëllimi i parë faqe 119-124

Java e shtatë:

1. Leximi i hadithit nr. 12 faqe 125. 2. Modestia e Muhamedit a.s. gjatë komunikimit me të tjerët. 3. Kujdesi për mësimin e çështjeve të rëndësishme. 4. Vlerësimi i

angazhimeve për çështje mësimore dhe lavdërimi para masës. 5. Nevoja që përgjigja të jetë sa më e saktë, e shkurtër dhe e qartë.

6. Leximi dhe komentimi i haditheve nr.19-20-21-22 faqe 128-131 7. Sqarimi i shtyllave bazë të Islamit. 8. Besimi në Allahun dhe Pejgamberin 9. Falja e Namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i ramazanit, haxhi

Literatura: Libri "Sahihu Muslim" vëllimi i parë faqe 125-132

Java e tetë:

1. Leximi i hadithit nr. 23 faqe 132 2. Komenti dhe lidhshmëria e haditheve të temës 3. Potencomi i disa ushqimeve dhe pijeve të ndaluara. 4. Nevoja e mësimin të fesë dhe komunikimit të tjerët. 5. Detyrat Islame nënkuptojnë zbatimin e urdhrave dhe largimin nga ndalesat.

6. Leximi i hadithit nr. 29 faqe 146 7. Përkthimi dhe komentimi i tekstit. 8. Rëndësia e thirrjes islame. 9. Dërgimi i misionarëve për qëllime humanitare. 10. Prioritetet e thirrjes. 11. Ndalimi i dhunës dhe pasojat e saj.

Literatura: Libri "Sahihu Muslim" vëllimi i parë faqe 132-148

Java e nëntë:

1. Leximi i hadithit nr. 32 faqe 150 2. Sqarimi i fjalëve dhe termave të panjohur, komenti gjeneral dhe zëbërthimi i tematikave. 3. Mënyra e zgjedhjes së Ebu Bekrit për halife, pas vdekjes së Muhamedit .a.s 4. Kush ishin ata që dezertuan nga Islami pas vdekjes së Muhamedit a.s. 5. Kush ishin pejgamberët e rrejtshëm dhe si u zhvillua ngjarja rreth tyre. 6. Si përfundoi përpjekja për përmbysjen e pushtetit pas vdekjes së Muhamedit a.s.

7. Leximi i hadithit nr. 39 faqe 161 8. Përqendrimi në domethëniet e hadithit dhe dispozitat që nxjerrim prej tij. 9. Kujdesi i Muhamedit a.s. dhe mëshira e tij ndaj xhaxhait Ebu Talibi. 10. Pranimi i pendimit edhe në momentet e fundit të jetës në këtë botë. 11. Ajetet që zbritën në lidhje me Ebu Talibin.

Literatura: Libri "Sahihu Muslim" vëllimi i parë faqe 150 -165

Java e dhjetë:

1. Komenti i hadithit nr. 43 2. Vlerësimet e dijetarëve mbi besimtarin mëkatar. 3. Qëndrimet e fraksioneve fetare në lidhje me çështjen. 4. Si mund të kuptojmë argumentet e ndryshme në lidhje me nevojën e shprehjes së besimit në mënyrë sistematike! 5. Komente dhe analiza rreth temës.

6. Hadithi nr. 44, faqe 168, lexim i tekstit, shkoqitje e domethënive. 7. Rrugëtimi i Muhamedit a.s. për në Tebuk. 8. Mbetja pa ushqim. 9. Lutja e Muhamedit a.s. dhe shtimi i ushqimit. 10. Mrekullitë e Pejgamberit a.s.

Literatura: Libri "Sahihu Muslim" vëllimi i parë faqe 167-173

Java e njëmbëdhjetë:Kollokfijum - seminare

Në orët praktike studentët do të punojnë në bibliotekë për të mësuar mënyrën e hulumtimit të temave që lidhen me tematikat në fjalë, respektivisht, mënyrën e gjetjes së haditheve që korrespondojnë me temën si referenca relevante

Java e dymbëdhjetë:

1. Leximi i hadithit nr. 47 faqe 174, përpunimi i tekstit, sqarimi i fjalëve dhe fjalive të panjohura. 2. Vlera e vizitës së personave në nevojë. 3. Rishikimi i sjelljeve dhe brengosja për veprat e kryera gjatë jetës. 4. Nevoja e njohjes së mentalitetit të njerëzve dhe droja nga keqkuptimi i asaj që e thua. 5. Mëkati i fshehjes së diturisë dhe mospublikimi i saj.

6. Leximi i hadithit nr. 48 faqe 176, sqarimi i tekstit dhe komentimi i domethënive të tij. 7. Mëshira e Muhamedit a.s. dhe sjellja e tij me tjerët. 8. Detyrat e njeriut ndaj Allahut dhe detyrat e Allahut ndaj njerëzve. 9. Tërheqja e vëmendjes së të

pranishmëve me rastin e shtrimit të pyetjeve. 10. Shfrytëzimi i kohës për çështje të dobishme dhe biseda serioze.

Literatura: Libri "Sahihu Muslim" vëllimi i parë faqe 174-179

Java e trembëdhjetë:

1. Leximi i hadithit nr. 52 faqe 180, sqarimi i fjalëve dhe termave të panjohur. 2. Vlera e ndejave të përbashkëta. 3. Interesimi dhe përkujdesi ndaj të parit dhe ati që ka vlera të veçanta. 4. Tërheqja nga publikimi i informatave e thënieve të cilat mund të shkaktojnë konfuzion apo mund të keqkuptohen. 5. Kthimi në mendimin e propozuar nga dikush kurdo që shohim ndonjë interes të caktuar.

6. Hadithi nr. 56 faqe 193, koment i përgjithshëm. 7. Shijimi i ëmbëlsisë së besimit. 8. Kënaqësia e besimit në Allahut për Zot, Islamin për fe dhe Muhamedin a.s për Pejgamber.

Literatura: Libri "Sahihu Muslim" vëllimi i dytë faqe 180 - 193

Java e katërbëdhjetë:

1. Leximi i haditheve nr. 57-58, sqarimi i termave dhe komentimi. 2. Tërësia e shkallëve të besimit, vlerat referente- shkalla më e ulët dhe më e larta. 3. Veprime që simbolizojnë besimin. 4. Të turpëruarit është pjesë e besimit.

5. Hadithi nr. 63-64 faqe, komentimi dhe nxjerrja e dispozitave. 6. Konfirmimi i dy vlerave të Islamit; Bujaria në ushqim dhe përshëndetja me selam. 7. Rregullat e përshëndetjes me selam dhe dispozitat përcjellëse. 8. Cilësitë e besimtarit më të mirë. 9. Ndalimi i dëmit që mund të shkaktoj dora apo gjuha.

Literatura: Libri "Sahihu Muslim" vëllimi i dytë, faqe 194-203

Java e pesëmbëdhjetë:

Përgatitja për provimin përfundimtar, testimi i njohurive të përgjithshme, hulumtimi i literaturës dhe diskutimi i çështjeve më të rëndësishme

Kriteret dhe komponentët e vlerësimit:

Prezantimi i rregullt dhe aktiviteti gjatë ligjëratave: **10 pikë**

Punimi seminarik: **10 pikë**

Leximi i tekstit të hadithit: **10 pikë**

Vlerësimi i testit të parë: **30 pikë**

Vlerësimi i testit të dytë: **40 pikë**

Literatura obliguese:

1. Sahihu Muslim, me koment të Muhji Ed Dijn En Nevevi, botoi "Daru El Ma'rifeti" Bejrut- Liban, 1999 (Libri mbi Imanin, kitabul iman, vëllimi i parë)

2. Skripti, materiali i gatshëm që u jepet studentëve, përkthim dhe komentim i librit bazë (Sahihu Muslim) përgatitur nga mësimdhënësi i lëndës Prof.asoc. Dr. Sulejman Osmani

(ky është materiali bazë për materien e lëndës së mësuar dhe përgatitjes për provim)

3. Sahihu i Muslimit, përkthim dhe komentim Dr. Shefik Kurdiq, përktheu në gjuhën shqipe Agim Avdiu, Shkup 2022 (vëllimi i parë nga faqe 57 deri 112)

Literatura konsultative:

1. *Kurani*; përkthim dhe komentim, përktheu: H. Sherif Ahmeti. Medinë, 1992.
2. *Sahihu i Buhariut*, përkthim në gjuhën shqipe, (grup përkthyesish). Botoi "Shuli" Prishtinë, 1994.
3. *Muhtesar Sahih El Buhari*, përzgjedhje nga: Zejnudin Ez Zebidi, Botues: AIITC Tiranë, 2009
4. Imam Neveviu, *Rijadus-Salihin*, Prishtinë, 1997

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Të gjithë studentët janë të obliguar të përcjellin ligjërata dhe të evidencohen me nënshkrim në listën e prezantimit. Kërkohej nga ta që të jenë vigjilent dhe aktiv, të përcjellin mësimdhënien dhe të japin kontributin e tyre në trajtimin e çështjeve. Her pas here mund të shtrohen edhe çështje të tjera që në një mënyrë apo tjetrën lidhen me temën dhe i kontribuojnë mësimdhënies apo mësimnxënies.

Rregullat e mirësjelljes paraqesin kodin e Islamit, normat e të cilit moralizojnë karakterin e studentit dhe fisnikërojnë moralin e tij. Studentët gjithsesi janë të ndikuar nga urtësitë e tilla. Se këndejmi ata duhet të kultivojnë mirësjelljen dhe edukatën e duhur si në raport me shokët e po ashtu edhe me objektet që i vihen në shërbim.